

**AKT THEMELIMI DHE STATUTI
I SHOQËRISË
“ ARGENT ” SH.P.K**

**TITULLI I
THEMELIMI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA**

**NENI 1
THEMELIMI, EMRI DHE THEMELUESIT**

Sot më datë 12/06/2023 themeluesit krijojnë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar nën emërtimin “ ARGENT ” sh.p.k, e cila vepron dhe organizohet në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Ortakët themelues të shoqërisë janë:

Z. Argent Peca , lindur më 12.08.1991 ne Arrëz , Kukës dhe banues në Tiranë , në adresën: Mëzez - Fushë ,Tiranë ,e me zotësi të plotë për të vepruar , identifikuar nëpërmjet ID Nr.Personal J10812119S , nr.tel +355696303082 .

**NENI 2
OBJEKTI I VEPRIMTARISË**

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë “ ARGENT ” sh.p.k është:

2.1 Agjensi këmbimi valutor, blerje dhe shitje valute.

2.2 Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër biznesi i cili nuk është i ndaluar nga ligji i zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë.

**NENI 3
KOHËZGJATJA**

Kohëzgjatja e shoqërisë “ ARGENT ” SH.P.K është e pakufizuar. Ajo mund të pushojë veprimtarinë e saj në çdo moment, sipas vendimit të Asamblesë së Ortakëve, sipas modaliteteve ligjore.

**NENI 4
SELIA E SHOQËRISË**

Selia e shoqërisë “ ARGENT ” SH.P.K. është në adresën: Njësia Administrative Nr.7 , Ish – Fusha e Aviacionit , Rruga Grigor Gjirokastriti , Pallati Nr.4, Tiranë. Tel. ++355696303082 ; E-mail: argentpeca2@gmail.com.

**NENI 5
DEGET, ZYRAT E PËRFAQËSIMIT DHE PJESMARRJET**

Shoqëria në përputhje me rregullimet ligjore në fuqi mund të hapë degë ose zyra përfaqësimi në Shqipëri ose jashtë saj dhe të fillojë dhe/ose të marrë pjesë në aktivitete të tjera të çdo forme.



TITULLI II KAPITALI, KUOTAT

NENI 6 KAPITALI I SHOQËRISË

Kapitali themeltar i shoqërisë është 2,500,000 (dymilionëpesëqindëmijë) Lekë i ndarë në një kuotë. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përpuhtje me kontribuutet e tyre të mëposhtëme:

1. Ortaku themelues **Z. Argent Peca**, zotëron një kuotë me vlerë 2,500,000 (dymilionëpesëqindëmijë) Lekë që përbën **100 % të kapitalit të shoqërisë**.

NENI 7 ÇERTIFIKATAT E KUOTAVE TË KAPITALIT

Ortaku, në momentin e marrjes së pronësisë së kuotave të kapitalit, fiton të drejtën të marrë pa pagesë një certifikatë për të gjitha kuotat që zotëron. Ky vërtetim nuk ka natyrën e letrës me vlerë.

NENI 8 KALIMI I KUOTAVE ME KONTRATE

Pjesët/kuotat e kapitalit janë lirisht të transferueshme.
Kontrata e kalimit të kuotës bëhet me shkrim dhe i njoftohet selisë së regjistruar të shoqërisë.

NENI 9

ZMADHIMI DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT

Ortakët me vendim mund ta zmadhojnë kapitalin, duke rritur numrin e kuotave ekzistuese ose duke rritur vlerën nominale të tyre. I njëjti vendim kërkohet edhe kur zmadhimi i kapitalit pritet t'u japë mundësi ortakëve të rinj të hyjnë në shoqëri.

Ortakët e shoqërisë mund të vendosin zvogëlimin e kapitalit themeltar.

Kapitali i Shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet kontributeve të reja të pjesëve të kapitalit themeltar me derdhje në para ose me kontribut në natyrë.

Vendimi për zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë i njoftohet QKB-se dhe publikohet në faqen e internetit të Shoqërisë.

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

NENI 10 FUNKSIONET E ASAMBLESESË SË PËRGJITHSHME

Të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga ortakët në përputhje me parashikimet e ligjit Nr. 9901, datë datë 14.4.2008 PËR TREGTARËT DHE SHOQËRITË TREGTARE.

Të gjitha vendimet e marra nga ortakët regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen.

TITULLI III
ADMINISTRATORI/ËT
NENI 11
EMËRIMI I ADMINISTRATORIT

Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. **Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje.** Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendren Kombëtare të Biznesit.

Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

Administrator i shoqërisë “ **ARGENT** ” sh.p.k, emërohet z. **Argent Peca** , lindur më **12.08.1991** ne **Arrëz** , **Kukës** dhe banues në **Tiranë** , në adresën: **Mëzez - Fushë** , **Tirane** , e me zotësi të plotë për të vepruar , identifikuar nëpërmjet **ID Nr.Personal J10812119S** , nr.tel **+355696303082** .

NENI 12
KOMPETENCAT DHE DETYRAT E ADMINISTRATORIT

1.Veprimtaria tregtare e shoqërisë menaxhohet nga Administratori i cili mund t'i ushtroj të gjitha kompetencat e shoqërisë që nuk i janë rezervuar Asamblesë së Përgjithshme apo nga Ligji.

a) kryen të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;

b) përfaqëson shoqërinë tregtare;

c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;

ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;

d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshmenë lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratori ka të drejtë të përfaqësoje shoqërinë në bankat dhe institucionet financiare brenda dhe jashtë Shqipërisë, dhe ai ka e drejta për të hapur llogari për kompaninë brenda dhe jashtë Shqipërisë. Administratori ka të drejtë të përfaqësoje shoqërinë në të gjitha institucionet shtetërore apo private brenda dhe jashtë shqipërisë, të zgjedhi avokat, apo të autorizojë persona të tretë për përfaqësim kur e lejon ligji.

Ai gjithashtu ka të drejtë të krijojë një ekip teknik, administrativ, ligjor dhe financiar dhe të miratojë ose refuzojë të emërojë çdo person që ai e konsideron të papërshtatshëm për të kryer kërkesat e punës, dhe ai ka të drejtë të nënshkruajë kontrata për emërimin e punëtorëve ose të përfundojë shërbimi i çdo punonjësi (ve).



TITULLI IV
DIVIDENDËT DHE KAPITALIZIMI I FITIMEVE

NENI 13
DIVIDENDËT

Pas përmbushjes së kërkesave të Nenit 77 të Ligjit, shoqëria, me anë të një vendimi të kualifikuar, mund të deklarojë shpërndarjen e dividendëve në përputhje me të drejtat përkatëse të ortakëve.

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga të drejtat që u lidhen kuotave, të gjithë dividendët deklarohen dhe paguhen në përputhje me shumat e paguara për kuotat në lidhje me të cilët paguhet dividendi. Të gjithë dividendët përpjesëtohen dhe paguhen në përpjesëtim me shumat e paguara për kuotat gjatë pjesës ose pjesëve të periudhës në lidhje me të cilat paguhet dividendi. Por, nëse kuotat emetohen me kushtin se merr dividend duke filluar nga një datë e caktuar, atëherë kuota në fjalë e merr dividendin sipas këtij kushti.

Asnjë dividend dhe asnjë mjet monetar i pagueshëm në lidhje me një kuotë nuk mund të fitojë interesa nga shoqëria nëse një gjë e tillë nuk parashikohet në të drejtat që i lidhen kuotës.

Nëse një dividend nuk është tërhequr pas dymbëdhjetë vjetëve nga data kur mund të tërhiqet pagesa, nëse Asambleja e Përgjithshme vendos me vendim të kualifikuar, ky dividend mund të anulohet dhe shoqëria nuk është më e detyruar ta paguajë.

TITULLI V
PRISHJA DHE NJOFTIMET
NENI 14
PRISHJA DHE LIKUIDIMI

Në rast të likuidimit të shoqërisë, likuiduesi, me autoritetin që i jep një vendim i kualifikuar i Asamblesë së Përgjithshme dhe në përputhje me Ligjin, mund t'u shpërndajë ortakut/ve të gjithë vlerën ose një pjesë të vlerës së pasurive të shoqërisë dhe, për këtë qëllim, mund t'i vlerësojë pasuritë dhe të përcaktojë se si të bëhet një shpërndarje e tillë midis ortakëve.

NENI 15
NJOFTIMET

Njoftimet që u bëhen ortakëve ose që bëjnë personat sipas Statutit duhet të jenë me shkrim me letër rekomande me marrje përgjigje në adresat respektive ose me post elektronike (e-mail).

ORTAKËT THEMELUES TË
SHOQËRISË
“ ARGENT ” SH.P.K

Z. Argent Peca

Argent Peca
